

VENDIM
Nr. 49, datë 31.1.2024

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË MASËS SË PËRFITIMIT TË
PAGESËS SË QIRASË PËR STREHIM PËR PUNONJËSIT E AGJENCISË SË
MBIKËQYRJES POLICORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 73, të ligjit nr. 128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e kriterëve dhe të masës së përfitimit të pagesës së qirasë për strehim për punonjësit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, të cilët transferohen në detyrë jashtë vendbanimit të përhershëm brenda vendit dhe të cilëve nuk u sigurohet nga Agjencia mjedisi për akomodim.

2. Kur punonjësi nuk ka në ngarkim persona të tjerë familjarë, me të cilët zhvendoset jashtë vendbanimit të përhershëm, i paguhet qiraja e banesës për sipërfaqe banimi deri në 30 (tridhjetë) m² neto. Për çdo person familjar shtesë, sipërfaqja neto shtohet me 10 (dhjetë) m².

3. Punonjësi i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, që transferohet jashtë vendbanimit të tij të përhershëm brenda vendit, përfiton kompensim për qira banese, nëse transferohet për shkak të detyrës, për nevoja pune, në largësi mbi 36 km.

4. Numri i personave, pjesëtarë të familjes, në ngarkim të punonjësit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, vërtetohet nëpërmjet certifikatës familjare, në momentin e transferimit.

5. Masa e përfitimit të kompensimit për strehim të jetë sa vlera minimale e qirasë mujore, sipas përcaktimeve në pikën 2, të vendimit nr. 469, datë 3.6.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”.

6. Punonjësi i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, që përfiton kompensim për qira banese, paraqet pranë strukturës përgjegjëse të burimeve njerëzore dokumentet e mëposhtme:

- a) kërkesën me shkrim për kompensimin e qirasë së banesës;
- b) fotokopjen e kartës së identitetit;
- c) kontratën e noterizuar të qirasë së banesës ku është transferuar;
- ç) vërtetimin nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës se ai ose pjesëtarët e familjes, që ka në certifikatën e gjendjes familjare, nuk kanë banesë apo nuk kanë aplikuar për legalizim banese, në juridiksionin ku është emëruar ose transferuar.

7. Punonjësi përfiton kompensim për qira, sipas këtij vendimi, për atë kohë sa zgjat transferimi i tij, ose deri në sistemimin me banesë të përhershme në vendin e punës ku është transferuar.

8. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Agjencia e Mbikëqyrjes Policore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama